



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
MUZEU HISTORIK KOMBËTAR
DREJTORI

Nr. 228/12 Prot.

Tiranë, më 10 . 07 . 2026

Lënda: Përfundimi i procedurës së rekrutimit për pozicionin vakant "Specialist për zhvillimin e audiencës dhe veprimtarive në komunikim dhe zhvillim".

Znj.Flonja LALAJ

SPECIALIST NË SEKTORIN E KOMUNIKIMIT DHE ZHVILLIMIT

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në përputhje me strukturën dhe organikën e miratuar të institucionit, si dhe me Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Muzeut Historik Kombëtar, miratuar me Urdhrin nr. 509, datë 09.12.2020, është ndjekur procedura e rregullt e rekrutimit për pozicionin vakant "Specialist për zhvillimin e audiencës dhe veprimtarive në komunikim dhe zhvillim".

Pozicioni "Specialist për zhvillimin e audiencës dhe veprimtarive në komunikim dhe zhvillim", u shpall publikisht më datë 29.06.2026, me afat për dorëzimin e aplikimeve deri më 06.07.2026, në përputhje me rregullat e transparencës dhe të barazisë në trajtimin e kandidatëve.

Me Urdhërin nr. 63, datë 06.07.2026, u ngrit Komisioni i Vlerësimit për të shqyrtuar dokumentacionin dhe për të ndjekur procedurat përkatëse të konkurrimit. Brenda afatit të përcaktuar ligjërisht u paraqitën 3 (tre) kandidatë, nga të cilët, pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur, 2 (dy) kandidatë u kualifikuan për fazën pasuese të vlerësimit përmes intervistës me gojë, i zhvilluar më datë 09.07.2026, në ambientet e institucionit.

Intervista është administruar në përputhje të plotë me parimet e ligjshmërisë, barazisë, objektivitetit dhe konfidencialitetit, si dhe me kërkesat specifike të vendit të punës. Pyetjet janë hartuar duke u mbështetur në profilin profesional të pozicionit dhe kërkesat e përshkruara në shpalljen publike.

Përsa më sipër, në cilësinë e Titullarit të institucionit, pasi konstatova, kryerjen dhe përfundimin e një procesi të rregullt administrativ dhe ligjor, të kryer nga komisioni i vlerësimit si dhe referuar relacionit me Nr.228/10 Prot, datë 10.07.2026 "Mbi përfundimin e procedurës së rekrutimit për pozicionin vakant " Specialist për zhvillimin e audiencës dhe veprimtarive në komunikim dhe zhvillim", vendosa:

Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re", kati II, godina e "Albafilm", Tiranë
www.mhk.gov.al, E-mail: muzeuhistorikkombetar@mhk.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË


**MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
MUZEU HISTORIK KOMBËTAR
DREJTORI**

1. Të shpall fitues kandidatin aplikant znj.Flonja LALAJ, për pozicionin e punës “Specialist për zhvillimin e audiencës dhe veprimtarive në komunikim dhe zhvillim”.
2. Ngarkohet punonjësi në detyrë i arkiv/protokollit për dorëzimin e këtij njoftimi.

Ky njoftim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI

Elenita ROSHI



Adresa: Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr. 76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”, kati II, godina e “Albafilm”, Tiranë
www.mhk.gov.al, E-mail: muzeuhistorikkombetar@mhk.gov.al